



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

Tiranë, më 02.02.2024

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si më poshtë vijon :

I. DREJTORIA E KONTROLLIT

➤ SEKTORI I KONTROLLIT TË SKEMAVE KOMBËTARE

2 SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ Detyrat kryesore:

- Siguron marrjen në dorëzim dhe kontrollin fizik të dosjeve për aplikimet e vlerësuara fituese nga komisionet e vlerësimit.
- Përgatit kryerjen e verifikimeve në terren të aplikimeve duke krahasuar rezultatet e faktit në terren me ato të aplikimit dhe duke i reflektuar në formularin e verifikimit.
- Analizon dhe verifikon rezultatet e kontrollit në formularin e verifikimit dhe në detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtoria.
- Dorëzon dosjet së bashku me formularin e verifikimit pranë Agjencisë së Pagesave, në Drejtorinë e përcaktuar sipas Udhëzimit dhe Rregullores së Brendshme.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional” në Arsim i Lartë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

II. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

➤ **OPERATORE** (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

- Ofron shërbim në recepsion dhe/ose në media sociale, numrin jeshil duke respektuar rregullat e etikës dhe komunikimit me qytetarët / fermerët.
- Informon dhe promovon programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit Bachelor në Arsimin e Lartë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesionale

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

➤ **SANITARE** (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

- Të pastrojë dhe të mirëmbajë nga ana higjienike sipërfaqen e zyrave, korridoreve, shkallëve të godinës që janë në administrim të AZHBR;
- Të kryejë pastrimin me detergjentët e duhur;
- Pastron tualetin, duke përfshirë këtu pastrimin e lavamanit, pasqyrës etj;

- U përgjigjet kërkesave shtesë të punonjësve për sa i përket sektorit të pastrimit;
- Boshatis mbeturinat, si dhe pastron mbajtësen e mbeturinave;
- Mban të gjitha pajisjet e pastrimit dhe materialet në gjendje pune të sigurt dhe sanitare.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Të kenë mbaruar arsim profesional / arsim i mesëm.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë përvojë pune të mëparshme.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 08.02.2024, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL